



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë 16.07.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 13.07.2020 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Professional Alarm LLC" për aktivitetin: "**Furnizimi dhe montimi i paisjeve për ngritjen e sigurisë së lendes arkivore në Arkivin Komunal të Prishtinës**" dhe me numër të prokurimit: **616 -19 -094-111** nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet** kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "Professional Alarm LLC" e datës 13.07.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit: "**Furnizimi dhe montimi i paisjeve për ngritjen e sigurisë së lendes arkivore në Arkivin Komunal të Prishtinës**" me Nr. 616 19 6729 111, me Nr. Brendshëm : 616 -19- 094-111 .
2. Autoriteti Kontraktues, vendos që *kete aktivitet ta vazhdoj sipas njoftimit te dates 08.07.2020* .
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "Professional Alarm LLC" me datë 13.07.2020 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "**Furnizimi dhe montimi i paisjeve për ngritjen e sigurisë së lendes arkivore në Arkivin Komunal të Prishtinës**" me numër të prokurimit Nr. 616 19 6729 111 dhe numër të brendshëm 616 19 094 111. Autoriteti Kontraktues, me datë 16.07.2020, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

-Pretendimet se pasi që nuk janë kërkuar sqarime në fazën e rivleresimit edhe me tutje tenderuesi i propozuar për kontratë duhet të jetë i pa përgjegjshëm janë të pa bazuara për faktin se konstatimi i me parme sipas kërkesës tuaj është bërë duke u bazuar vetëm

pretndimet tuaja dhe ne shifra pa analize te vertete profesionale,ndersa komisioni profesional rivleresimt ka konstatuar se te gjitha specifikimet teknike te paarqitura nga ky tenderues jane te pranueshme.Lidhur me kete do ta keni te bashkengjitur edhe raportin e komisionit;

-Pretendimi juaj se pergjegja jone ka qene se mund te ofertoni me produkte ekuivalente dhe se sipas jush tani nuk mund te gjindet produkti ekuivalent,atehere ju eshte dashte te paraqitni kundershtimin-ankesen tuaj dhe te mos konkuroni me produkte qe nuk perputhen me specifikimet teknike te kerkuara;

-Pretendimi se jeni eliminuar ne menyre te padrejte lidhur me kohen e shkarkimit/zbrazjes dhe kohen e ndezjes eshte plotesisht i pa bazuar pasi qe parametrat e produktit tuaj jane shume larg nga kerkesat ne specifikimet teknike te dosjes.

Shtojce:Bashkengjitur raporti i komisionit profesional.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimi te ketij vendimi.**


Zyrtari përgjegjës i Prokurimit

RAPORTI VLERËSIMIT TEKNIK TË TENDERIT

“Furnizimi dhe montimi i pajisjeve për ngritjen e sigurisë së lëndës arkivore në Arkivin Komunal të Komunës së Prishtinës” me nr. Prokurimit 616 19 094 111

Të nderuar me datë: 06.09.2020 jemi ftuar si anëtarë të komisionit për vlerësimin e tenderit **“Furnizimi dhe montimi i pajisjeve për ngritjen e sigurisë së lëndës arkivore në Arkivin Komunal të Komunës së Prishtinës” me nr. Prokurimit 616 19 094 111** nga kryetari i KK Prishtinës z. Shpend Ahmeti.

Komisioni ka filluar punën me datë: 17.06.2020 dhe pas vlerësimit të dosjes së tenderit për secilin OE veç e veç nxjerrim këtë raport:

Kriteret kryesore sipas FDT-së: **Kapaciteti teknik dhe profesional pika 1.6 ku kerkes ka qene Operatori Ekonomik apo grupi duhet të ofroj certifikaten nga ndonjë agjencion laboratorik I akredituar si EPA-SNAP apo tjetër që deshmon se aerosoli I ofruar mund të perdoret për hapsirat e zenura – banuara me njerëz (for normally occupied spaces).**

1. SISTEMI AUTOMATIK I FIKJES SË ZJARRIT ME AEROSOLL:

Kriteri themelore I kërkuar nga AK që nuk e plotësojnë OE “Profesional Alarm L.L.C” dhe Konsociumi “Inet & Termovent” (të dy këto kompani kanë ofertuar me gjenerator aerosol të njëjtë – DSPA):

- Sipas agjencionit EPA – SNAP gjeneratori aerosol DSPA është i aprovuar për hapësira të pabanuara me njerëz (ang. Approved for unoccupied spaces: ref. nga katalogu *ang.*: The DSPA generators are mainly designed to use in normally unoccupied and unoccupied areas and are effective on class A, B, C fires.) ndërsa është kërkuar të jetë i aprovuar për hapësira të banuara me njerëz (ang. Approved for occupied spaces)
- Kompania **“E connect Al sh.p.k”** ka ofruar certifikaten ref. 11 Certifikatat : *ang.* C.1. Powdered Aerosol E (**FirePro**) – EPA is adding Powdered Aerosol E to the list of acceptable substitutes for total flooding uses, which would include both occupied and unoccupied spaces) I cili është kriter kryesor në tender për sigurinë e personelit i cili qëndron me orë të tëra në arkivim apo kërkim të dokumenteve;



Të gjeturat për pikën:

Kapaciteti teknik dhe profesional:

1. SISTEMI AUTOMATIK I FIKJES SË ZJARRIT ME AEROSOLL - 1.3. Operatori ekonomik apo Grupi me rastin e ofertimit duhet të dorëzoj specifikim teknik të detajuar dhe katalogjet me emërtimet dhe kodet përkatëse të produkteve që i ofron dhe

Dëshmia 1.3. Specifikimi teknik i detajuar dhe katalogjet e prodhuesit me emërtimet dhe kodet përkatëse;

Nga oferta e OE "Profesional Alarm L.L.C" dhe Konsociumi "Inet & Termovent" kemi të gjeturat si në vijim:

1. Gjeneratorit Aerosol DSPA I mungon porta e dytë (sistemin dual) ku do të vendosej BTA (*ang.* Bulb Thermal Actuator – Lampa me Shkrepje Termale) për aktivizim termik autonom (poz. në paramasë: 1.1.11, 1.2.4, 1.3.11, 1.4.11, 1.5.4, 1.6.11, 1.7.4, 1.8.11, 1.9.4, 2.1.11 dhe 2.2.4);
2. I Mungon pajisja BTA (poz. në paramasë: 1.1.11, 1.2.4, 1.3.11, 1.4.11, 1.5.4, 1.6.11, 1.7.4, 1.8.11, 1.9.4, 2.1.11 dhe 2.2.4) në katalogun e gjeneratorëve DSPA. Mekanizmi i aktivizimit Termik, me Bulb Thermal Actuator (BTA), 57°C;
3. Mungon në katalog - Shenja sinjalizuese e lëshimit të gazit – Shenja sinjalizuese e aktivizimit të aerosolit për fikje të zjarrit (FL-24) (*ang.* Gas Release Sign) (poz. në paramasë 1.1.7, 1.3.7, 1.4.7, 1.5.4, 1.6.7, 1.8.7, 2.1.7.);
4. Kufia ose korniza e gjeneratorëve aerosol e DSPA nuk është nga materiali Inox. (Ref. katalogun) por është nga hekuri i ngjyrosur me ngjyrë të kuqe, ndërsa është kërkuar të jetë nga materiali inox që nuk është në përputhje me specifikat e (poz. në paramasë: 1.1.11, 1.2.4, 1.3.11, 1.4.11, 1.5.4, 1.6.11, 1.7.4, 1.8.11, 1.9.4, 2.1.11 dhe 2.2.4);
5. Koha e zbrazjes së gjeneratorit aerosol DSPA që kanë ofruar OE të lartëcekur, është prej 78 sekondave (ndërsa është kërkuar nga AK që zbrazja të jetë 15-20 sekonda) që nuk është në përputhje me specifikat e (poz. në paramasë 1.1.11, 1.2.4, 1.3.11, 1.4.11, 1.5.4, 1.6.11, 1.7.4, 1.8.11, 1.9.4, 2.1.11 dhe 2.2.4) ;

Nga oferta e OE "E Connect Al sh.p.k" kemi të gjeturat si në vijim:

1. Gjeneratori Aerosol FirePro posedon portën e dytë (sistemin dual) ku do të vendosej BTA (*ang.* Bulb Thermal Actuator – Lampa me Shkrepje Termale) për aktivizim termik autonom (poz. në paramasë 1.1.11, 1.2.4, 1.3.11, 1.4.11, 1.5.4, 1.6.11, 1.7.4, 1.8.11, 1.9.4, 2.1.11 dhe 2.2.4);
2. Gjeneratori FirePro posedon Pajisjen BTA - Mekanizmi i aktivizimit Termik, me Bulb Thermal Actuator (BTA), 57°C si dhe është prezantuar në katalogun e FirePro faqe 31/D66 – dokumenti 15. Broshurat (poz. në paramasë 1.1.11, 1.2.4, 1.3.11, 1.4.11, 1.5.4, 1.6.11, 1.7.4, 1.8.11, 1.9.4, 2.1.11 dhe 2.2.4).;
3. Posedon Shenjën sinjalizuese për lëshimin e gazit – Shenja sinjalizuese e aktivizimit të aerosolit për fikje të zjarrit (FL-24) (*ang.* Gas Release Sign). si dhe është prezantuar në

katalogun e FirePro faqe 32/F84 – dokumenti 15. Broshurat. (poz. në paramasë 1.1.7, 1.3.7, 1.4.7, 1.5.4, 1.6.7, 1.8.7, 2.1.7.);

4. Kutia ose korniza e gjeneratorëve aerosol e FirePro është nga materiali Inox. dhe është prezantuar në katalogun e FirePro faqe 28/A25 dhe faqe 30/A21 – dokumenti 15) dhe kjo ndikon në rritjen e jetëgjatësisë së shtëpizës së gjeneratorit ndaj korrozionit (poz. në paramasë: 1.1.11, 1.2.4, 1.3.11, 1.4.11, 1.5.4, 1.6.11, 1.7.4, 1.8.11, 1.9.4, 2.1.11 dhe 2.2.4);
5. Gjithashtu koha e zbrazjes së gjeneratorit aerosol FirePro është 15-20 sekonda; (poz. në paramasë 1.1.11, 1.2.4, 1.3.11, 1.4.11, 1.5.4, 1.6.11, 1.7.4, 1.8.11, 1.9.4, 2.1.11 dhe 2.2.4) që është në përputhje me kërkesën e AK –së.

Edhe pse Kërkesa 1.3 në specifika teknike është nën pikë e pikës 1. **SISTEMI AUTOMATIK I FIKJES SË ZJARRIT ME AEROSOLL**, OE kanë dorëzuar edhe katalogjet e **2. INTERVENIMI NË RRJETIN EKZISTUES TË VENTILIMIT DHE NGROJES QENDRORE** dhe **3. KONTROLLI I QASJES DHE RRYMAT E DOBËTA** dhe kryesisht I përmbushin specifikat teknike të kërkuara nga AK dhe janë të pranueshme nga ana e komisionit.

Vërejtjet nga OE “Profesional Alarm L.L.C” kanë të bëjnë me fazën **3. KONTROLLI I QASJES DHE RRYMAT E DOBËTA** (për pikën 3.1.1; 3.1.2; 3.1.3; 3.1.4;; 3.1.11, 3.2.2; 3.2.3 dhe 3.2.5) nuk janë kritere të kërkuara nga AK pasi që nuk janë të përfshira si kritere në FDT, te pika **III.2.4)** në faqen 4/7:

**III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional dhe dëshmia e kërkuar dokumentare:
1.SISTEMI AUTOMATIK I FIKJES SË ZJARRIT ME AEROSOLL**

- **1.3.Operatori ekonomik apo Grupi me rastin e ofertimit duhet të dorëzoj specifikim teknik te detajuar dhe katalogjet me emërtimet dhe kodet përkatëse të produkteve që i ofron dhe**

Dëshmia

1.3. Specifikimi teknik I detajuar dhe katalogjet e prodhuesit me emërtimet dhe kodet përkatëse;

Komisioni në bazë të vlerësimit të tenderit “**Furnizimi dhe montimi I pajisjeve për ngritjen e sigurisë së lëndës arkivore në Arkivin Komunal të Komunës së Prishtinës**” me nr. Prokurimit 616 19 094 111. Rekomandon që OE “E connect A.l sh.p.k” i plotëson të gjitha Kriteret kryesore sipas FDT-së: **Kapaciteti teknik dhe profesional dhe Dëshmia e kërkuar dokumentare**, si dhe në bazë të LPP për çmimin më të ulët të ofruar OE “E connect A.l sh.p.k” është fitues i tenderit: “**Furnizimi dhe montimi i pajisjeve për ngritjen e sigurisë së lëndës arkivore në Arkivin Komunal të Komunës së Prishtinës**”.

Me respekt,

Prishtinë, më datë: 06.07.2020